



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Elbasan

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "11 Nentori", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: ëëë.elbasani.gov.al

Nr 1117 Prot.

Elbasan 08/02/2017

Vendim

Nr. 55 Date 08/02/2017

Per miratimin e rregullorese se organizimit dhe funksionimit te Bashkise

Nisur nga nevoja per riorganizimin e administrates se Bashkise per tia pershtatur funksioneve dhe detyrave te reja qe burojne nga ndarja e re administrativo-territoriale, bazuar ne ligjin 139/2015 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";

Vendosa

- 1-Te miratoj Rregulloren per Organizimin dhe Funksionimin e Administrates se Bashkise" sipas tekstit bashkangjitur pjese perberese e ketij vendimi.
- 2-Te gjithë punonjesit e Bashkise jane te detyruar per zbatimin dhe respektimin e kesaj rregulloreje, dhe Drejtoria e Burimeve Njerezore do te beje monitorimin e zbatimit dhe respektimit te saj nga te gjithë punonjesit.
- 3-Drejtoria e Burimeve Njerezore tua komunikojë dhe shperndaje te gjitha drejtorive te pergjithshme, lagjeve dhe njesive administrative kopje te kesaj rregulloreje.
- 4-Drejtoret e Pergjithshem, Agjensite dhe Institucionet Vartese sa me pare por jo me vone se data 20/02/2017 te hartojne pershkrimet e punes ne formen e rregulloreve te brendshme te çdo strukture qe do jete pjese perberese e Rregullore se Organizimit dhe Funksionimit te Bashkise miratuar me kete vendim per cdo pozicion ne varesi te tyre dhe ti paraqesin per miratim tek zv/ Kryetaret e prore.
- 5-Ngarkohen zv/kryetaret dhe te gjitha strukturat administrative te Bashkise me zbatimin e ketij vendimi.
- 6-Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

Kryetari

Qazim SEJDINI



-*-

RREGULLORE

PER ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATES SE BASHKISE ELBASAN

Kjo rregullore hartohet, bazuar në ligjin 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” dhe ka si qëllim administrimin e aktivitetit të Bashkisë për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj.

Kreu I Objektivat dhe simbolet

Neni 1 Objektivat e rregullores

- 1- Te krijoje nje kuader rregullator per te realizuar funksionimin me eficence dhe efikasitet te administrates se Bashkise per realizimin e funksioneve publike te bashkise.
- 2- Te krijoje nje kuader te detyrave dhe ndarjeve te tyre ndermjet strukturave te bashkise ne funksion te realizimit te funksioneve publike dhe zbatimit te kompetencave te bashkise per cdo funksion, si dhe te percaktoje rregullat e bashkepunimit ndermjet strukturave te ndryshme te bashkise.
- 3- Te krijoje kushtet per nje veprimtari transparente, te hapur dhe llogaridhenese te administrates se Bashkise, ndaj publikut dhe organeve shteterore.

Neni 2 Pershkrimi I termave

Per efekt te kesa rregulloreje, termat e perdorur kane kuptimin si me poshte:

Administrata e Bashkise: Kryetari I Bashkise, nepunesit funksionare politike, nepunesit dhe punonjesit e tjere te Bashkise.

Akt: Cdo vendim, urdher, urdherese, kontrate, rezolute apo cdo disponim tjetër që ka efektin e te mesipermeve që ka lidhje me zbatimin e kompetencave dhe realizimin e funksioneve publike te Bashkise/Komunes, I nxjerre nga organet kompetente dhe sipas procedurave dhe standarteve te percaktuara nga ligji, statuti I Bashkise/Komunes dhe kjo rregullore.

Funksion: Fusha e veprimtarise se Bashkise per te cilen ajo eshte pergjegjese per administrimin, financimin, rregullimin etj.

Kompetence: Autoriteti I Bashkise/Komunes, I dhene me ligj per realizimin e funksioneve te veta, te perbashketa dhe te deleguara.

Buxhet: Programi vjetor financiar I Bashkise/Komunes ne te cilin perfshihen te ardhurat, shpenzimet dhe investimet e Bashkise/Komunes, per realizimin e funksioneve publike.

Epror direkt: Eshte sipas rastit, pergjegjesi I sektorit per punonjesit e sektorit, drejtori i drejtorise per pergjegjesit e sektoreve, drejtori i pergjithshem per drejtoret e drejtorive, n/kryetari I bashkise per drejtoret e pergjithshem qe I jane lene ne varesi, dhe kryetari I bashkise per n/kryetaret dhe strukturat te cilet varen direkt prej tij.

Juridiksion: Eshte sipas rastit, juridiksioni territorial, lendor apo administrativ, brenda te cilit bashkia ushtron funksionet dhe kompetencat e saj.



